REPUBLIKA E SHQIPËRISË

2419

BASHKIA MALIQ
DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE

Maliq më 22.04.2026

Projekt-Vendim - NR.5
Për "Dhënien e Ndihmës Financiare për familjet në nevojë"

Në mbështetje të ligjit nr .139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore",ligji nr 9936,datë 26.06.2008,"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" dhe ligjit 121/2016 , "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Shqipëri" dhe në bazë të verifikimeve të bëra nga punonjësit e Ndihmës Ekonomike Maliq, të Njësive të Bashkisë Maliq për gjendjen social-ekonomike të familjeve i kërkojmë Këshillit të Bashkisë:

I. Miratim fondi për familjet e mëposhtëme:

Nr.	Emri Mbiemri	ID	Nj.Administrative	Shuma /Lekë
1	Anesti Kolonja	I20418228S	Maliq	40.000
2	Flamur Petriti	H41018013T	Libonik	40.000
3	Niko Poçka	I80601047I	Vreshtas	20.000
4	Manushaqe Kapllani	I15526099A	Pojan	20.000
5	Rita Hyskolli	G95927017U	Libonik	10.000

II. Fondet do të përballohen nga Buxheti i vitit 2026, si më poshtë :

Gr.	Kod. Prog.	Llog.eko	Emert.Llogarise	Vlera në lekë
00	010430	606	Fondi Social	130 000

III. Bashkëngjitur projekt-vendimit relacionin me gjëndjen Social–Ekonomike të familjes.

Konceptoi Pergj.Sek I Politikave Sociale
Miratoi:Dr. Drejtoria e Shërbimeve Sociale

(Emër Mbiemër)
J.Hoxha
E.Petrit

Nënshkrimi

KRYETARI I BASHKISË
Gëzim Topçiu

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALIQ

Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë
Tel. & Fax. 0861 2 2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE

Maliq më 22.04.2026

Relacion
Për "Dhënien e Ndihmës Financiare për familjet në nevojë"

Në mbështetje të ligjit nr .139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore",ligji nr 9936,datë 26.06.2008,"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" dhe ligjit 121/2016 , "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Shqipëri" dhe në bazë të verifikimeve të bëra nga punonjësit e Ndihmës Ekonomike Maliq, të Njësive të Bashkisë Maliq për gjendjen social-ekonomike të familjeve të mëposhtme rezultoi se:

1.Anesti Kolonja.

Z. Anesti Kolonja është banor i qytetit Maliq, në Bashkinë Maliq. Prej një kohe të gjatë, ai kujdesej për nënën e tij të sëmurë, znj. Tanja Kolonja, e cila vuante nga disa sëmundje të pashërueshme.Gjendja e tyre ekonomike ka qenë e rënduar, ku e vetmja e ardhur ishte pensioni i znj. Tanja. Para disa ditësh, ajo ndërroi jetë, duke e përkeqësuar edhe më tej gjendjen ekonomike të familjes.Në këto kushte, i drejtohemi Këshillit Bashkiak Maliq për miratimin e një ndihme financiare, me qëllim përballimin e shpenzimeve të varrimit.

2.Flamur Petriti.

Z. Flamur Petriti është banor i fshatit Symiz, Njësia Administrative Libonik, Bashkia Maliq. Ai jeton i vetëm në banesën e tij, e cila ndodhet në gjendje të amortizuar.Së fundmi, z. Petriti ka kryer një ndërhyrje kirurgjikale në sy, e cila i ka shkaktuar shpenzime të konsiderueshme, duke i konsumuar të gjitha kursimet e tij. Gjendja e tij shëndetësore kërkon vizita periodike dhe trajtim të vazhdueshëm mjekësor.Të ardhurat e tij të vetme janë nga pensioni, i cili nuk është i mjaftueshëm për të përballuar shpenzimet mujore dhe nevojat bazë të jetesës. Duke qenë se jeton i vetëm dhe pa mbështetje familjare, ai e ka të pamundur të përballojë këto kosto. Në këto kushte, i drejtohemi Këshillit Bashkiak Maliq për miratimin e një ndihme financiare, me qëllim përballimin e shpenzimeve të domosdoshme.

3. Niko Poçka.

Z. Niko Poçka është banor i fshatit Podgorie, Njësia Administrative Vreshtas, Bashkia Maliq. Ai jeton i vetëm, pasi është braktisur nga familjarët.Kohët e fundit, z. Poçka ka shfaqur probleme të shëndetit mendor dhe psikologjik, duke e vështirësuar më tej gjendjen e tij sociale dhe ekonomike. Gjithashtu, para disa muajsh, banesa në të cilën ai jetonte është përfshirë nga flakët, duke shkaktuar djegien e plotë të orendive dhe sendeve shtëpiake.Si pasojë e kësaj situate, ai ndodhet në kushte tepër të vështira jetese. Të ardhurat e tij të vetme sigurohen nga përfitimi i ndihmës ekonomike, e cila nuk është e mjaftueshme për përballimin e nevojave bazë.Në këto kushte, duke marrë në konsideratë gjendjen e rënduar social-ekonomike dhe shëndetësore të tij, i drejtohemi Këshillit Bashkiak Maliq për miratimin e një ndihme financiare, me qëllim përballimin e shpenzimeve të domosdoshme.

4.Manushaqe Kapllani.

Familja e znj. Manushaqe Kapllani përbëhet nga 4 (katër) anëtarë dhe jeton në Njësinë Administrative Pojan, Bashkia Maliq.Kjo familje ndodhet në kushte të vështira ekonomike dhe shëndetësore. Znj. Kapllani është grua e ve dhe kujdeset e vetme për 3 (tre) fëmijët e saj.Djali i vogël, 6 (gjashtë) vjeç, vuan nga një sëmundje e rëndë, me diagnozë: epilepsi e gjeneralizuar rezistente, si dhe prapambetje mendore në nivel mesatar deri të rëndë. Gjendja e tij shëndetësore kërkon trajtim të vazhdueshëm dhe shpenzime të konsiderueshme.Të ardhurat e familjes janë të pamjaftueshme për të përballuar këto shpenzime, pasi burimi i vetëm i të ardhurave është ndihma ekonomike dhe pagesa e aftësisë së kufizuar që përfiton fëmija.Në këto kushte, znj. Manushaqe Kapllani i drejtohet Këshillit Bashkiak me kërkesë për përfitimin e një ndihme financiare, me qëllim përballimin e shpenzimeve të nevojshme për trajtimin dhe kujdesin e djalit të saj. Në këto kushte, i drejtohemi Këshillit Bashkiak Maliq për miratimin e një ndihme financiare, me qëllim përballimin e shpenzimeve të domosdoshme.

5.Rita Hyskolli.

Znj. Rita Hyskolli është banore e fshatit Drithas, Njësia Administrative Libonik, Bashkia Maliq. Ajo jeton e vetme, pasi prej shumë vitesh është e divorcuar.Gjendja e saj shëndetësore dhe psikologjike paraqitet e rënduar, pasi trajtohet me pagesë për aftësi të kufizuar me diagnozën "çrregullim skizoafektiv, tipi depresiv". Aktualisht, znj.Rita jeton në banesën e motrës së saj.Kohët e fundit, ajo i është nënshtruar një ndërhyrjeje kirurgjikale në sy, ndërkohë që gjendja e saj shëndetësore kërkon ndjekje të vazhdueshme mjekësore, vizita të herëpashershme dhe trajtim

të rregullt me medikamente.Të ardhurat e saj janë të pamjaftueshme për të përballuar shpenzimet e përditshme dhe ato shëndetësore. Në këto kushte, duke marrë në konsideratë gjendjen e rënduar social-ekonomike dhe shëndetësore të saj, i drejtohemi Këshillit Bashkiak Maliq për shqyrtimin dhe miratimin e një ndihme financiare, me qëllim përballimin e shpenzimeve të domosdoshme.

Konceptoi Pergj.Sek I Politikave Sociale
Miratoi:Dr. Drejtoria e Shërbimeve Sociale

(Emër Mbiemër)
J.Hoxha
E.Petriti

Nënshkrimi

KRYETARI I BASHKISË
Gëzim Topçiu

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ